



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 37

Tiranë – E hënë, 23 nëntor 2020

PËRMBAJTJA

Faqe

Njoftim i Ministrisë së
Infrastrukturës dhe Energjisë
nr. 8189, datë 23.11.2020

Për publikimin e ftesës për ofertë për procesin konkurrues, për
përzgjedhjen e ofertuesit “Për zhvillimin e projektit që do të
përfitojë masat mbështetëse për ndërtimin e impiantit fotovoltaike
në zonën e Spitallës”.....

3



NJOFTIM

Nr. 8189, datë 23.11.2020

**PËR PUBLIKIMIN E FTESËS PËR
OFERTË PËR PROCESIN KONKURRUES,
PËR PËRZGJEDHJEN E OFERTUESIT
“PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTIT QË DO
TË PËRFITOJË MASAT MBËSHTETËSE
PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT
FOTOVOLTAIK NË ZONËN
E SPITALLËS”**

Bazuar në vendimin nr. 349, datë 12.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe të erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”, të ndryshuar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall këtë ftesë për ofertë, për procesin konkurrues për përzgjedhjen e ofertuesit “Për zhvillimin e projektit për ndërtimin e impiantit fotovoltaik, në zonën e Spitallës, Durrës, Shqipëri”.

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË FTESË PËR OFERTË**

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktues:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë, adresa: rruga “Abdi Toptani”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri.

2. Emri dhe adresa e personave të kontaktit:

Znj. Jonida Rika, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Email: jonida.rika@infrastruktura.gov.al

Për dijeni: Z. Gjergji Simaku, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Email: gjergji.simaku@infrastruktura.gov.al

3. Forma, objekti dhe lloji i kontraktimit:

Përzgjedhja e ofertuesit për projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një impiantit fotovoltaik për gjenerimin e energjisë elektrike, në zonën e Spitallës, qarku Durrës, me një kapacitet të instaluar 100 MWp, nga të cilat 70 MWp si pjesë e masave mbështetëse, dhe me një kapacitet shtesë të instaluar prej 30 MWp, i cili nuk do të jetë pjesë e masave mbështetëse.

4. Lloji i procesit konkurrues: Procedurë e hapur.

5. Vendndodhja e Projektit: Impianti fotovoltaik do të ketë vendndodhjen në zonën e Spitallës, qarku Durrës, Shqipëri.

6. Kohëzgjatja e marrëveshjes së zhvillimit të projektit: 30 vjet (sipas specifikimeve të parashikuara në dokumentet e procesit konkurrues).

7. Marrëveshja e blerjes së energjisë elektrike: Si pjesë e masave mbështetëse, marrëveshja për blerjen e energjisë elektrike do të nënshkruhet për kapacitetin 70 MWp, me një afat prej 15 vjetësh.

8. Afati për dorëzimin e ofertave: Datë 1 shkurt 2021, ora 16:00, ora e Evropës Qendrore.

9. Hapja e ofertave: Datë 8 shkurt 2021, ora 12:00, ora e Evropës Qendrore.

10. Periudha e vlefshmërisë së ofertës: Ofertat duhet të jenë të vlefshme për një periudhë 180 ditë nga afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

11. Sigurimi i ofertës: Garancia e ofertës, në shumën prej 400,000.00 eurosh (Katërqind mijë euro), duhet të jetë e vlefshme për një periudhë prej 180 ditësh nga afati për dorëzimin e ofertave.

12. Blerja e dokumenteve të procesit konkurrues: Dokumentet e procesit konkurrues mund të blihen duke filluar nga data 19 nëntor 2020, kundrejt pagesës prej 2,000 eurosh (dy mijë euro). Paga do të kryhet në llogarinë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Blerja e dokumenteve të procesit konkurrues mund të bëhet me kërkesë edhe nëpërmjet postës elektronike, në pikat e kontaktit, sipas pikës 2 të këtij njoftimi. Pas pagesës, subjekti dërgon kopje të mandatapagesës në MIE ose nëpërmjet postës elektronike.

13. Dokumentet e tenderit: Ata që kanë paguar tarifën e pjesëmarrjes, do të kenë të drejtë të marrin dokumentet e tenderit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, pas datës 19 nëntor 2020 çdo ditë pune, nga ora 10:00 deri në orën 14:00 CET. Me anë të kërkesës me postë elektronike, mund të kërkohet dhe kopja elektronike e dokumenteve, pasi të jetë kryer pagesa.

14. Pranimi dhe vlerësimi i ofertës: Sipas përcaktimeve në dokumentet e procesit konkurrues.

Informacion shtesë mbi dokumentet e procesit konkurrues mund të gjendet në *website*-in e autoritetit kontraktues: <http://infrastruktura.gov.al>.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Viola Haxhiademi

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2020